

Procesverbal

Nga Mbledhja IV (e katërt) e rregullt për vitin 2026 e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 28.04.2026

Rend Dite

1. **Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e katërt të rregullt; dhe**
3. **Eventuale.**

Resul Fetahu: Përshëndetje kryetar, kolegë delegatë, OSBE, të pranishëm të tjerë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen e IV-të të rregullt të KPF-së për vitin 2026. Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë, ku i kemi tri pika të rendit të ditës dhe për seancë janë paraparë pesë pika të rendit të ditës dhe pika eventuale. A do dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë kush është për rendin e ditës të KPF-së? A ka kundër? Abstenim? Me 7 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, a do dikush me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 7 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe procesverbalin e seancës së kaluar.

Vazhdojmë me pikën e dytë të shqyrtimit të materialit të Kuvendit, me Rishqyrtimin e vendimit 01 Nr.060/01-2909/26, për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimi e punës në teren për zgjedhjen e këshillave lokale. Kush don me marrë fjalën? Z.Artan Loshaj e ka fjalën.

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë. Pasi që jemi në Komitet unë do të jem shumë i shkurtër dhe më tepër do të flas në seancë. Ky vendim që është kthyer prapë dhe ku MAPL-ja e ka dhënë një arsyetim ku thuhet se komisioni do të reflektojë përfaqësimin gjinor dhe etnik, nga 6 anëtar të komisionit të gjithë janë meshkujë dhe e kemi bërë si odë të burrave, kuota gjinore duhet të rrespektohet dhe të shohim nesër a do t'i ndërrojm apo jo? se kemi edhe nga PDK-ja. Edhe përfaqësimi etnik duhet të jetë që besojë se edhe 4 me 2 por edhe 3 me 3 nuk është problem. Unë e kam një propozim që i nderuari z.Uzair Hamza gjithsesi të jetë në këtë komision se pa këtë asnjë komision komunal nuk mund të funksionoj, ky është shumë i mirë edhe kur duhet kuota gjinore dhe etnike sepse mundet ai edhe boshnjak, bullgar..etj krejt kriteret i plotëson ai është i pa-zëvendësueshëm. Domethënë unë e propozoj që ai të jetë në listë, ju faleminderit.

Resul Fetahu: Falemnderit Artan. A don dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim a ka? Atëherë konstatojmë se me 7 vota për, zero kundër dhe zero abstenim miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e tretë, Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun 2026 – 2030. Kush do me marrë fjalën?

Artan Loshaj: Po shkojmë te 3.1 faqen 9 -Përceptimi ku thuhet këtu se sipas një anketës 53% komuna e Dragashit raporton në nivele të larta të informacionit, shumë mirë, në takimet publike pjesëmarrja ka qenë 30%, mos është ndonjë gabim këtu sepse unë me sa e di, prej 28 mijë me marrë pjesë nëpër takime 30% i bjerë me qenë diku 7-8 mijë prezent, mos është ndonjë lëshim këtu. Unë me sa e di i kemi edhe fotot këtu që janë mbajtë dëgjimet publike

kanë qenë kryetari, punëtorët e administratës, të spitalit dhe disa fëmijë të shkollës së mesme, a po ndoshta unë jam gabim? Më poshtë thuhet se kanë qenë të kënaqur 90% me punimet është shumë për tu çuditur, kur e dijmë se çfarë cilësi ka në komunë të Dragashit. Është për të ardhur keq me këtë raport. 3.5 Komunikimi i brendshëm, këtu dëshirojë të rezervohet për hir të disa individëve që kam rrespekt se për komunikim të brendshëm sa ka Komuna, ne e dijmë shumë mirë qysh janë raportet dhe çfarë raporte ka ekzekutivi mes veti, drejtorat nuk po hyjm aty për shkak të rrespektit për disa individë. Në faqen 11, ka një nivel të kënaqshëm të komunikimit në mes të organeve të ekzekutivit dhe legjislativit. Në të gjitha mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme kryetari i Komunës merr pjesë, është e vërtetë dhe rrespekt për kryetarin, i cili së bashku me drejtorët komunal u përgjigjet kandidatëve të kuvendarëve në lidhje me ecurinë e punëve, ne e dimë shumë mirë kryetarë që i ke ja dy “smart” drejtorë që na përzihen në punën e Kuvendit vend e pa vend. Disa drejtorë kur duhet me raportue për planin e punës nuk vijnë këtu, unë e di që është për marketing për performancë por më ëmbël e ma butë pak. Janë ata drejtorë të SDU-së që kurrë nuk vijnë në mbledhje, kur raportohet këtu ata nuk janë prezent. Janë edhe dy të z.Adem Hoxha që nuk kanë raportuar ose s’kanë çfarë të raportojnë. Nesër në seancë do të diskutojmë më tepër.

Fari Kolloni: Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket këtyre komenteve që i bëre, besoj se nuk ka nevojë shumë për sqarim. Tek pika 3.1, tek përceptimi i qytetarëve, do të thotë sot unë do ta marr linkun e këtyre dokumenteve që e kanë publikuar Demosi dhe Helvetasi. Kam me publiku edhe bashkangjitë në këtë draft dokument. Besoj që nuk ka ndonjë gabim teknik këtu. Domethënë këtu ne jemi referuar kësaj ankete të Demosit dhe Helvetasit. Nuk është diçka të cilën e kemi hartuar ne ose përpiluar. Ju faleminderit.

Artan Loshaj: z.Fari, me gjithë respektin si qytetar dhe punëtor i komunës, edhe pse kemi raporte shumë të mira, në cilësinë e kujt dole këtu me diskutu, sepse nuk po të kuptoj. Seriozisht nuk po të nënçmoj, në cilësinë e kujt dole këtu për të diskutuar. Vetëm desha të di se në cilësinë e kujt po diskuton, si ndonjë shef i ndonjë zyre apo si anëtar. Mirë, në rregull. Ndoshta unë jam gabim që i keni 30 përqind, por ne i kemi edhe fotot, sepse ju i keni në qef fotot. Kanë qenë publike ato takime dhe këtu kanë qenë vetëm dy rreshta, punëtorët e komunës edhe kanë qenë disa nxënës të shkollës së mesme. E ku janë referuar ata, unë nuk e di. Ndoshta unë jam gabim. Unë në bazë të fotografive të cilat janë postuar në faqën zyrtare të komunës së Dragashit, unë i kam parë që janë diku 20-30 persona. Ku kryesisht kanë qenë punëtorët e administratës dhe disa kolegë të mi të spitalit. Kështu që, besoj se jemi të qartë.

Resul Fetahu: Falemnderit. Kush do me marrë fjalën? Nëse nuk ka, e hedhim në votim. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim a ka? Konstatojmë se me 5 vota për, zero kundër dhe 1 abstenim miratohet edhe kjo pikë. Vazhdojmë me pikën e katërt, Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar janar – mars për vitin 2026. A don dikush me marrë fjalën? Nëse nuk ka, e çesim në votim. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim a ka? Atëherë konstatojmë se me 5 vota për, 1 kundër dhe zero abstenim miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e pestë, Propozim për bartjen e mjeteve vetanake të pa shpenzuara nga viti 2025 në vitin 2026. A do dikush me marrë fjalën? Nëse nuk ka, atëherë e hedhim në votim. Kush është për? Kush është kundër? A ka abstenim? Konstatojmë se me 6 vota për, zero kundër dhe 1 abstenim miratohet edhe kjo pikë.

Para se të kalojmë në pikën e fundit, kemi disa kërkesa që janë drejtuar KPF-së. Fillojmë me kërkesën e parë nga z.Azi Rifaj, zyrtarë komunal nga fshati Bellobrad, kjo kërkesë është për shëndetësi dhe ja lëmë kryetarit këtë. Kërkesa e dytë është nga Ilir Bajrami i cili ka kërkuar mjete për nënën e tij për shëndetësi, po ashtu ja lëmë kryetarit. Kërkesa e tretë nga z.Shukri

Nebiu për shërim edhe këtë do të ja lëmë krytarit. Dhe kërkesa e katërt për shërim nga z.Miradete Elmazi nga fshati Shajne, mirëpo kjo e ka dokumentacionin prej Prizrenit që jeton në Prizren dhe vitin e kaluar i kemi lëshuar mjete kurse për këtë vitë nuk kemi mundësi. Atëherë kush do me marrë fjalën?

Artan Loshaj: Unë si anëtar i komitetit, kur është në pyetje për shëndetësi, nuk e diskutojë. Mua më po më intereson, pasi që edhe kryetari është doktor dhe ky person vitin e kaluar ka marrë mjete dhe jeton në Prizren. Kurrë nuk do të jam kundër për personat që kanë nevojë për shërim, sepse vet jam punëtor shëndetësor. Në qoftë se ndonjëri është urgjent, pasi që edhe këto dallojnë, pse për fat të keq dikush e ka bërë këtë si trend çdo vit me kërkuar mjete për shërim. E po më vjen keq për disa që janë me prioritet dhe kryetari nuk mundet të japë më shumë se një mijë euro, nëse dikush ka nevojë me të vërtetë, sepse edhe kryetari vet është mjek dhe ka edhe këshilltarën punëtor shëndetësor që ka ndonjë diagnozë, atëherë me të vërtetë duhet t'i ndihmohet. Sepse ka persona që kanë bërë kërkesa çdo vit, në kohën e pandemisë e ka bërë kërkesën dhe vetëm e ka renovuar atë raportin mjekësor, domethënë i ka ndryshuar datën edhe e ka bërë. Në qoftë se ka mjete, është mirë që kryetari së paku me ia nda nga një mijë euro. Unë gjithmonë do të jem pro mjeteve të cilat kërkohen për shëndetësi. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: A don dikush tjetër me marrë fjalën? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është për me refuzue këtë kërkesë pasi që ka pengesa ligjore, nuk ka adresë të komunës së Dragashit është qytetare e Prizrenit. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim?

Artan Loshaj: Atëherë, në qoftë se është joligjore, është dashtë që ju mos me sjell këtu, sepse e keni zyrtarin ligjor dhe për këta paguhet. Në regull, nuk ka të drejtë mos me e sjellë. Atëherë unë jam për me bo dhe ligji le ta refuzon. Sepse ne po dalim shumë keq. Kur po duhet këto të tjerat, ne po themi t'ja lëmë kryetarit. Në qoftë se është joligjore, atëherë po më vjen turp sepse ai është skuqur kur i ka sjellë këto dokumente dhe ka me të vërtetë probleme shëndetësore, ne nuk po diskutojmë. Unë po them, në qoftë se kjo kërkesë është joligjore, sepse keni pasur shumë kërkesa të tjera ku ju i keni refuzuar nëpër zyra dhe nuk i keni sjellur këtu, atëherë në qoftë se është joligjore, unë nuk e di pse e keni sjellur këtu. E atëherë le të vendosën ligji dhe kryetari.

Resul Fetahu: Atëherë e lëmë këtë kërkesë dhe i çesim në votim këto tri kërkesat tjera për me ja bart kryetarit. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë konstatojmë se me 5 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, i kalojnë kryetarit këto kërkesa. Atëherë vazhdojmë me kërkesën e radhës, Kryqi i Kuq – dega në Dragash ka kërkesë sikur çdo vit për me e subvencionue, ku ka kërkuar 2350 euro. Kush është për që kjo kërkesë t'i kalojë kryetarit? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë konstatojmë se me 6 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, i kalonë kryetarit kërkesa. Atëherë e kemi edhe një kërkesë nga Sindikata e Policisë së Kosovës për përkrahje materiale nga kryetari i shoqatës z.Shaqir Uka. Atëherë po j'au lexojë kërkesën:

Të nderuar!

Po ju drejtohem me nje Kerkese si Kryetar i Shoqates Sindikale te Policise te Rajonit te Prizrenit/ Dragash.

Sindikata e Policise ka Planifikuar ta beje nje vizite ne Turqi , me zyrtaret te Policise se Dragashit, perkatesishte ne Stamboll nje vizite tre ditore me datat 07.05.2026 deri 10.05.2026.

Ju njoftoje se nje pjese te shpenzimeve do ta heqe vet Sindikata , por kemi nevojë për perkrashjen e juaj.

Duke pare bashkepunimin e vazhdueshem me Kuvendin Komunal dhe perkrashjen e vazhdueshme nga ana e juaj, po ju drejtohem me kete kerkese per Perkrashje materiale me shumen prej 1500 euro per ta perkrashur aktivitetin e Sindikates se Policise se Kosoves.

Artan Loshaj: Një sqarim po dua t'a di, respekt shumë për Policinë e Kosovës, ky është komandanti i stacionit policor, a po? A ka bërë kërkesë për policët e regjionit të Prizrenit? Si është e mundur që kryetari i stacionit policor të jetë edhe kryetar i sindikatës? Kjo është në kundërshtim me ligjin. Unë nuk po e kuptoj. A ka bërë kërkesë për policët e regjionit të Prizrenit, pesëdhjetë policë të regjionit të Prizrenit dhe jo të komunës së Dragashit. Në qoftë se shkojnë policë të komunës tonë, po, por në qoftë se shkojnë policët e komunës së Prizrenit, komuna e Prizrenit ka me miliona euro dhe unë jam kundër.

Bexhet Xheladini: Përshëndetje për të gjithë, lidhur me kërkesën e sindikatës, do të thotë ky ka kërkuar më shumë se një mijë euro, po të kishte kërkuar më pak, atëherë do të ishte drejtuar kryetarit. Mirëpo është fjala për sindikatën e Policisë së Stacionit Policor të Dragashit. Do të thotë këta dojnë me shku me bë një vizitë studimore, por do të thotë këta po shkojnë në nivel regjional. Mirëpo këto mjete, kërkojnë për subvencionimin e policëve tonë. Që policët tonë do t'i bashkëngjiten këtësaj vizite si një vizitë studimore, ashtu si i bëjmë edhe ne. Kështu që unë jam i mendimit që komiteti me votue jo në shumën të cilën ata e kanë kërkuar, për shembull le të jetë mbi 1.000 euro, 1.050 euro. Pra, është çështje e juaja se si ju vendosni. Është fjala për policët tonë të stacionit policor të Dragashit. Ju faliminderit.

Xhyllferie Bahtijari: Përshëndetje për të gjithë. Mua më intereson më shumë data se kur do ta kryejnë ata vizitën. Pra, 9 maj, atëherë ata nuk kanë shumë hapësirë që për me ba ata një kërkesë, sepse ata me bo një kërkesë të re dhe me regullue, pasi që gjithëkund po shkruan në rajonin e Prizrenit. Dhe kjo faktikisht po bie në kundërshtim me gjithçka që kemi punuar deri më tani. Nëse ka mundësi që me ri-përpunue edhe një herë këtë kërkesë, me e bo pak më të përshtatshme, që ne mos të dalim në pozitë të keqe. Përndryshe, ne jemi për me i ndihmue policët tonë, të cilët janë nga komuna e Dragashit. Nëse nuk vërtetohet që ata policë nuk janë nga Dragashi, atëherë edhe unë jam kundër. Nëse ne fillojmë edhe i finansojmë policët e rajonit të Prizrenit si komunë, atëherë unë nuk do të isha e pajtimt me këtë kërkesë. Ju faliminderit.

Artan Loshaj: Kryesues po kërkoj falje që po dal jashtë kësaj, por është çështje e ndjeshme. Pasi po dal shumë keq. Vetë zyrtari tha që një qytetar nga komuna tjetër nuk mund të subvencionohet për shkak të ligjit. Ne po ia lëshojmë 1900 euro. Por në qoftë se është kërkesa e komunës së regjionit të Prizrenit, atëherë ministria do ta kthej prapë. E ju atëherë duhet me e prit vendimin e ministrisë për me ja lëshu këto mjete dhe nuk kemi kohë. Është një kërkesë e imja, që unë si asambleist i PDK-së, Artan Loshaj, në qoftë se është kërkesa e singertë dhe është kërkesë për policët e komunës së Dragashit, të cilët punojnë dhe ju ofrojnë shërbim qytetarëve tonë, unë propozoj që t'ju lëshohet deri në shumën maksimale që kemi mundësi.

Bexhet Xheladini: z.Shaqir Uka është komandant edhe i sindikatës së rajonit të Prizrenit, edhe i Dragashit, i Rahovecit edhe i Suharekës. Do të thotë këu është kryetar i nivelit rajonal, por këu e ka bërë kërkesën në emër edhe për policët tonë që janë këtu në komunën e Dragashit. Pra ju vendosni, mendimi jem është që nuk ka nevojë mbi një mijë euro edhe përgjegjësinë e marr unë.

Uran Halimi: Përshëndetje për të gjithë, tek kërkesa e Policisë së Kosovës, nëse ne marrim një vendim edhe e subvencionojmë, atëherë bëjmë diçka të paligjshme. Ne si Komitet dalim të paaftë, pasi që e dimë se kjo kërkesa e Prizrenit nuk na takon neve. Ky kryetari i sindikatës ka qenë më e rrugës që t'i drejtohet kryetarit të Prizrenit është si qendër e rajonit, por nëse ne e përkrahim, sot ne bëjmë një veprim të jashtëligjshëm. Kemi thënë se një banorë të Prizrenit nuk mundim me e subvencionue, atëherë qysh po mundim me e subvencionue një kryetar të sindikatës së rajonit të Prizrenit? Atëherë është ma mirë që kryetari t'i ndihmoj si kryetar, sesa ne si Komitet, pasi që dalim si të paaftë, a po kupton? Sepse ne me vetëdije po bëjmë diçka që është e jashtëligjshme edhe po ta bëjmë këtë, neve kjo do të na kthehet prapë. Ata do të mbesin edhe pa 999 euro. Pra, nëse nuk kthehet prapë kërkesa e sindikatës së policisë, atëherë ne do ta subvencionojmë edhe atë qytetarin tjetër. Me një pako po i fusim të dyjat. Si mos të kthehet prapë kjo, nuk kthehet as ajo tjetra. Ju faleminderit.

Xhyllferie Bahtijari: Atëherë, meqë kryetari po i din hollësitë dhe ashtu kanë biseduar në takim, problemi i vetëm është që nuk e ka shkruajtur askund që janë të komunës së Dragashit ata që kanë me marrë pjesë, kryetari është në dijeni për këtë punë. Unë jam e mendimit që me ja bart kryetarit këtë përgjegjësi dhe jemi në regull, ndoshta.

Resul Fetahu: Atëherë e çesim në votim që këtë kërkesë me ja bart kryetarit. Kush është për? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë konstatojmë se me 7 vota për, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet edhe kjo kërkesë që t'i bartet krytarit. Kalojmë në pikën eventuale. A don dikush me marrë fjalën?

Artan Loshaj: Për pikën eventuale e kam një kërkesë të vogël. Rreth çështjes së ujit të pijshëm, sepse në Facebook kam parë një kërkesë të qytetarëve të fshatit Brezne, nuk po duhet sot shumë me diskutue. A ka mundësi që nesër me na dhënë shpjegime, por të jetë prezent edhe shefi i Hidroregjionit ose ndonjë zyrtar i tyre, të shohim se çka është puna me ujin në fshatin Brezne, në Pllavë, në Dragash dhe në këto pesëmbëdhjetë fshatra, sepse ka shumë ankesa dhe ne këtu banojmë që 30 vite. Ka banuar edhe drejtori dhe e di shumë mirë, që kur bjerë shi, ujë të pijshëm nuk ka. Unë e kam edhe një kërkesë për buxhetin, unë kërkoj që në vitin 2027 të fusim në buxhet ndërtimin e ujësjellësit dhe kanalizimit në qytetin e Dragashit. Por nesër është mirë që të jetë prezent edhe një anëtar i Hidroregjionit këtu, që unë si asambleist me mund me bo pyetje për cilat janë në interes të qytetarëve. Ju faleminderit.

Resul Fetahu: A don ndonjë kush tjetër me marrë fjalën? Nëse nuk ka, atëherë e mbyllim këtë seancë. Shihemi nesër në Seancën e Kuvendit.